



**Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”  
Fakulteti i Edukimit**

**Programi i studimit:  
Pedagogji e Përgjithshme**

*Niveli i studimeve:*  
Bachelor

*Numri i kredive:*  
180 ECTS

*Akredituar për periudhën:*  
1 Tetor 2014- 30 Shtator 2019

*Hartimi i këtyre materialeve është bërë me ndihmën e projektit "Modernizimi i Shkollimit të Mësimdhënësve në Universitetin e Prishtinës, nr. 544023" financiar nga Bashkimi Europian.*

*The European Commission support for the production of this publication does not constitute an endorsement of the contents which reflects the views only of the authors, and the Commission cannot be held responsible for any use which may be made of the information contained therein.*

## **PËRMBAJTJA:**

1. QËLLIMI DHE PROFILI I PROGRAMIT TË STUDIMIT .....	4
2. REZULTATET E PRITURA: .....	5
3. PROGRAMI STUDIMOR: Pedagogji e përgjithshme.....	6
4. PËRSHKRIMI PËR SECILIN KURS .....	8

## **1. QËLLIMI DHE PROFILI I PROGRAMIT TË STUDIMIT**

Qëllimi i programit të Pedagogjisë së përgjithshme është: përgatitja e kandidatëve, të cilët do të analizojnë, vlerësojnë dhe reflektojnë në mënyrë kritike për problemet aktuale pedagogjike dhe që në mënyrë kualitative do të zbatojnë teorinë dhe praktikën bashkëkohore si bashkëpunëtorë profesionalë në institucionet pedagogjike, sociale e kulturore.

Ky program studimi i nivelit Bachelor synon arsimimin bazik për çështje pedagogjike me përqendrim në lëndë që kanë të bëjnë me aspektet teorike e praktike në sferën pedagogjike, sociale e kulturore.

## **2. REZULTATET E PRITURA:**

Me përfundimin e suksesshëm të programit të studimeve, studentët do të jenë në gjendje të:

- Dallojnë kategoritë themelore pedagogjike (edukata, arsimit, mësimi);
- Interpretojnë specifikat e procesit edukativo-arsimor në tërësi dhe në nivele të veçanta institucionale (parashkollore, fillore, dhe të larta), në familje dhe forma të ndryshme të arsimimit joformal;
- Analizojnë rrugën e zhvillimit të ideve pedagogjike dhe t'i ndërlidhin ato me trendet aktuale në arsimin bashkëkohor;
- Ndihmojnë në hartimin e programeve për zhvillimin individual të nxënësve në përgjithësi dhe atyre me nevoja të veçanta;
- Bëjnë hulumtime në fushën e shkollës dhe të arsimit dhe të marrin pjesë në zbatimin e projekteve;
- Asistojnë dhe mbështesin mësimdhënësit në menaxhimin e klasës;
- Avancojnë komunikimin shkollë-familje-komunitet;
- Promovojnë ecuri bashkëkohore të vlerësimit të punës së nxënësve në arritjen e kompetencave të parapara sipas niveleve të shkollimit;
- Kontribuojnë për organizimin e zhvillimit profesional të vazhdueshëm në nivel shkolle, duke i sensibilizuar të tjerët për mësim gjatë gjithë jetës;
- Analizojnë në praktikë shembuj të komunikimit profesional dhe të avancojnë kulturën komunikuese në nivel institucioni.

### 3. PROGRAMI STUDIMOR: Pedagogji e përgjithshme

#### VITI I PARË

##### SEMESTRI I

Nr.	Lënda	Statusi	L+U	ECTS
1.	Hyrje në pedagogji	O	3+	7
2.	Histori e pedagogjisë botërore	O	3+2	6
3.	Psikologji e përgjithshme	O	2+2	6
4.	Edukimi për të drejtat e fëmijëve	O	3+2	6
5.	Gjuhë angleze	O	0+3	5
<b>Gjithsej</b>			<b>11+11</b>	<b>30</b>

##### SEMESTRI II

Nr.	Lënda	Statusi	L+U	ECTS
1.	Pedagogji shkollore me punë praktike	O	3+2	7
2.	Kibernetikë pedagogjike	O	3+2	6
3.	Pedagogji kombëtare	O	3+2	7
4.	Etika dhe mësimdhënia	O	3+2	5
5.	Pedagogji familjare	O	3+2	5
<b>Gjithsej</b>			<b>15+10</b>	<b>30</b>

#### VITI I DYTË

##### SEMESTRI III

Nr.	Lënda	Statusi	L+U	ECTS
1.	Pedagogji sistematike-I (edukimi fizik, shëndetësor, seksuale dhe intelektual)	O	3+2	7
2.	Bazat e didaktikës	O	3+2	7
3.	Bazat e metodologjisë pedagogjike	O	3+2	6
4.	Edukimi për kohë të lirë	Z	2+1	5
5.	Braktisja e shkollës	Z	2+1	5
6.	Arsimimi gjatë gjithë jetës	Z	2+1	5
7.	Psikologji e zhvillimit	Z	2+1	5
<b>Gjithsej</b>			<b>13+8</b>	<b>30</b>

**SEMESTRI IV**

Nr.	Lënda	Statusi	L+U	ECTS
1.	Pedagogji sistematike-II (edukimi socio-moral, estetik dhe punues)	O	3+2	7
2.	Teoria pedagogjike e kurrikulës	O	3+2	7
3.	Statistikë pedagogjike	O	3+2	6
4.	Informimi dhe orientimi profesional	Z	2+1	5
5.	Menaxhimi i projekteve	Z	2+1	5
6.	Zhvillimi profesional i mësimdhënësve	Z	2+1	5
7.	Pedagogji e masmediave	Z	2+1	5
<b>Gjithsej</b>			<b>13+8</b>	<b>30</b>

**VITI I TRETË****SEMESTRI V**

Nr.	Lënda	Statusi	L+U	ECTS
1.	Pedagogji speciale	O	3+2	7
2.	Andragogji	O	3+2	7
3.	Bazat teknologjike të punës mësimore	O	3+2	6
4.	Shkathtësitë e studimit akademik	Z	2+1	5
5.	Puna instruktive pedagogjike	Z	2+1	5
6.	Metodat e punës social-pedagogjike	Z	2+1	5
7.	Psikologjie e edukimit	Z	2+1	5
<b>Gjithsej</b>			<b>13+8</b>	<b>30</b>

**SEMESTRI VI**

Nr.	Lënda	Statusi	L+U	ECTS
1.	Metodikë me punë praktike	O	3+2	7
2.	Pedagogji parashkollore me punë praktike	O	3+2	6
3.	Pedagogji komparative	O	3+2	7
4.	Punim i diplomës	O		5
5.	Standardet në arsim	Z	2+1	5
6.	Pedagogji e përkujdesjes dhe strehimit	Z	2+1	5
7.	Vështirësitë në të nxënë	Z	2+1	5
8.	Edukimi dhe sjelljet devijonte	Z	2+1	5
<b>Gjithsej</b>			<b>13+8</b>	<b>30</b>

#### 4. PËRSHKRIMI PËR SECILIN KURS

Përshkrimi për secilin kurs	
1	<p><b>Hyrje në pedagogji</b></p> <p>Nga ky kurs do t'u ofrohen studentëve përmbajtje thelbësore për çështjet e përgjithshme të edukimit dhe të arsimit, për zanafillën dhe karakteristikat e tij si dhe për rëndësinë që ka për formimin e individit dhe të shoqërisë. Të zotërojnë dituri për ligjshmëritë e procesit të edukimit dhe të arsimit dhe për karakteristikat e veçoritë qenësore që përfaqësojnë. Të mësojnë gjithashtu për tiparet e sistemit arsimor demokratik, për reformën e arsimit, për misionin dhe tiparet e arsimitarit të shkollës sonë sot. Për edukimin demokratik dhe synimet e tij për të ardhmen e shoqërisë bashkëkohore multikulturore.</p>
2	<p><b>Histori e pedagogjisë botërore</b></p> <p>Historia e pedagogjisë botërore ngërthen trajektoren e zhvillimit historik të edukatës, arsimit mendimit pedagogjikë dhe të sistemeve edukativo-arsimore në shkallë botërore, nga lashtësia deri në kohën tonë, duke u përqendruar sidomos, në ngjarje, ndryshime dhe personalitete të veçanta në këtë fushë.</p>
3	<p><b>Psikologji e përgjithshme</b></p> <p>Brenda kursit <i>Psikologji e përgjithshme</i> janë përfshirë çështjet mbi objektin e studimit të psikologjisë, mënyrat e realizimit të hulumtimeve psikologjike, proceset njohëse ose kognitive, emocionet, motivacioni njerëzor, çështjet e personalitetit, temperamentit dhe tipave të temperamentit. Në vazhdim janë përfshirë konstatimet lidhur me aftësitë e individit dhe inteligjencën. Kah fundi i kursit analizohen edhe dy grupe problemesh: komunikimi njerëzor dhe problemet lidhur me jetën e përditshme e stresin.</p>
4	<p><b>Edukimi për të drejtat e fëmijëve</b></p> <p>Ky kurs trajton parimet udhërrëfyese të të drejtave njerëzore të fëmijës. Aspirata për të mbrojtur identitetin dhe dinjitetin e të gjitha qenieve njerëzore, pa përjashtuar fëmijët, paraqet thelbin e konceptit për të drejtat e njeriut. Kjo aspiratë e vë mirëqenien e fëmijës në qendër të interesit, vëmendjes dhe përkushtimit tonë. Si e tillë, ajo bazohet në kornizën, e cila ngërthen sistemin e vlerave të përbashkëta universale të mbrojtura përmes standardeve të pranuar ndërkombëtarisht, njohura si Konventa për të Drejtat e Fëmijës. Ky kurs kërkon të përgatisë studentët të formulojnë pyetje dhe argumentojnë përgjigje sa i përket çështjes së të drejtave të fëmijëve e të rinjve, me të cilat janë përballur vetë ose mund të përballen gjatë përvojave të tyre jetësore, duke i analizuar ato në raport me realitetet ekzistuese.</p>



5	<p><b>Gjuhë angleze</b></p> <p>Kursi zhvillon aftësitë e leximit, të folurit, shkrimit dhe të dëgjimit, prezanton gramatikën në një mënyrë, e cila ofron ushtrime për tejkalimin e problemeve të zakonshme në strukturën dhe aplikimin e kohëve. Kursi përmban tema të ndryshme nga jeta e përditshme, kultura dhe përdoren tekste autentike, të cilat kanë për qëllim ngritjen e nivelit të leximit, kuptimit dhe komunikimit gojor e me shkrim nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme.</p>
6	<p><b>Pedagogji shkollore me punë praktike</b></p> <p>Në këtë kurs ofrohen njohuritë bazike nga fusha e pedagogjisë shkollore, duke filluar me konceptin bazë shkollë, ku do qartësohen diferencat mes shkollës tradicionale dhe bashkëkohore. Ofron mundësinë e njohjes së zhvillimit historik të shkollës, teoritë më të rëndësishme mbi shkollën, deri te organizimi i sotëm bashkëkohor i saj, madje ajo është e bazuar në kornizën e organizimit bashkëkohorë të shkollës. Studentët përmes kësaj lënde do njihen edhe me mënyrën e udhëheqjes dhe mbikëqyrjes së shkollës, përvojë kjo, që do të jetë nën përcjelljen dhe mbikëqyrjen e pedagogut të shkollës. Lënda trajton parimet udhërrëfyese të përparimit të shkollës.</p>
7	<p><b>Kibernetikë pedagogjike</b></p> <p>Kursi <i>Kibernetikë pedagogjike</i> përmban informacione nga sfera e udhëheqjes, komunikimit dhe të qeverisurit në veprimtarinë arsimore edukative në nivele të ndryshme të shkollimit. Kursi ofron përmbajtje për shkathtësitë themelore intelektuale (të dëgjuarit, të folurit, të shkruarit dhe të lexuarit) në kontekst të zotërimit dhe praktikimit të tyre efikas në përditshmëri. Kursi përmban edhe dimensionin e vështrimit kronologjik të kibernetikës, duke filluar nga Platoni e deri të Wineri) si dhe pavarësimin e saj në shoqërinë moderne. Në kurs do të ofrohen përmbajtje teorike për sistemin informativ, sistemin e komunikimit dhe elementet përmbajtjesore të tyre. Do të trajtohet gjithanshëm edhe mësimi nga aspekti kibernetik (si qeverisje dhe udhëheqje komunikologjike). Do të analizohen përmbajtje nga sfera e informacionit didaktik dhe teorisë së përgjithshme të sistemeve si dhe kuptimi dhe aktualiteti i algoritmeve për mësimdhënie kualitative. Do të trajtohet edhe ndihmesa e kibernetikës në inovimin e mësimimit dhe të nxënit elektronik, shikuar edhe nga aspekti i të nxënit në largësi.</p>
8	<p><b>Pedagogji kombëtare</b></p> <p>Pedagogjia kombëtare ngërthen trajktoren e zhvillimit historik të arsimit dhe mendimit pedagogjik shqiptar nga lashtësia deri në kohën tonë, duke u</p>

	përqendruar sidomos, në ngjarjet, ndryshimet, institucionet dhe personalitetet më të shquara të arsimit kombëtar.
9	<p><b>Etika dhe mësimdhënia</b></p> <p>Në këtë kurs trajtohet themelësia filozofike e pedagogjisë, shikuar nga aspekti normativ i filozofisë së edukimit. Kursi udhëzon njohjen dhe respektimin e parimeve morale si nevojë e domosdoshme për çdo profesion e aq më tepër për profesionin e mësimdhënësit. Në kurs trajtohen aspektet më të përgjithshme të profilit të punonjësit arsimor, duke filluar nga fillet e para të organizimit spontan të transmisionit të diturive, shprehive dhe shkathtësive në kontekstin gjenerativ e deri te profili i punonjësit në shoqërinë bashkëkohore. Në kurs trajtohen të drejtat dhe obligimet morale, që duhet t'i posedojë mësimdhënësi për të realizuar raportet ndërnjerëzore në veprimtarinë arsimore. Kursi promovon tri aktivitetet kryesore të veprimtarisë arsimore të punonjësit arsimor, duke filluar nga dituritë, vendimmarrja dhe sjellja, si shkathtësi të pashmangshme, të cilat e karakterizojnë personalitetin e mësimdhënësit.</p>
10	<p><b>Pedagogji familjare</b></p> <p>Kursi ndërthen njohuri bazike nga pedagogjia familjare, tipologjitë e familjeve, ligjësitë dhe proceset e edukimit familjar; përmbajtje përkitazi me faktorët primarë edukativë në familje, karakteristikat e edukimit në moshë të ndryshme, rrethanat specifike të edukimit të fëmijëve, njohuri për procesin e partneritetit edukativ brenda familjes dhe në mikromjedise tjera socio-edukative.</p>
11	<p><b>Pedagogji sistematike-I (edukimi fizik, shëndetësor, seksual dhe intelektual)</b></p> <p>Kursi ofron njohuri bazike nga fusha e edukimit fizik, shëndetësor e seksual si dhe nga fusha e edukimit intelektual të personalitetit; ofron përmbajtje për procesin, faktorët, parimet, metodat, mjetet, format, etj. të edukimit fizik, shëndetësor e seksual; ofron përmbajtje përkitazi me procesin, respektivisht metodologjinë e edukimit intelektual.</p>
12	<p><b>Bazat e didaktikës</b></p> <p>Ky kurs është i ndarë në dy pjesë: pjesa e parë – të nxënës dhe pjesa e dytë – mësimdhënia. Kursi ofrohet për të promovuar filozofinë dhe strategjinë bashkëkohore të të nxënës dhe mësimdhënies. Përmes këtij kursi ofrohen njohuri e shkathtësi themelore përkitazi me të nxënës, teoritë e të nxënës, stilet e të nxënës, konceptet rreth mësimdhënies, strategjive ndërvepruese të mësimdhënies, format e punës mësimore, planifikimi i punës mësimore,</p>

vlerësimi, etj. Studentët do të kenë mundësinë të analizojnë teoritë e të nxënit dhe të mësimdhënies dhe të zbatojnë strategji ndërvepruese të mësimdhënies, të cilat promovojnë të menduarit kritik dhe kreativ. Gjithashtu, studentët do të analizojnë plane të punës mësimore mbi bazën bashkëkohore të mësimdhënies dhe analizës së bërë në praktikën pedagogjike të shkollës kosovare.

13

#### Bazat e metodologjisë pedagogjike

Ky kurs ofron njohuritë bazike nga fusha e metodologjisë pedagogjike, duke nisur nga njohja e teorive, paradigmave dhe këndvështrimeve, e deri te lidhja e këtyre elementeve me botën e vërtetë të praktikës së hulumtimit. Studentët do të njihen me fazat e hulumtimit shkencor, me të gjitha karakteristikat dhe rëndësinë e zbatimit të tyre. Aftësimi i studentëve për mësuar se si planifikohet një projektit hulumtimi me tërë elementet e veta, do të jetë fokus i veçantë i këtij kursi, duke u përqendruar në çështjen e formulimit të pyetjeve hulumtuese, si dhe përkufizimet e qarta operative, me qëllim që puna jonë si hulumtues të jetë e kuptueshme dhe e vlefshme. Ky proces studimor bëhet më domethënës me njohjen e kampionëve (mostrave), proces ky që është i domosdoshëm të përvetësohet mirë nga studentët, në mënyrë që hulumtimi të arrijë vlerën shkencore. Njohuritë e tyre do të zgjerohen edhe më shumë me njohjen e teknikave të rëndësishme për mbledhjen e të dhënave. Përmes këtij kursi studentët do të njihen dhe aftësohen për shqyrtimin e literaturës, si një nga fazat më të rëndësishme në kryerjen e hulumtimit, duke bërë të mundur shqyrtimin kritik të saj, gjetjen e informacionit dhe vlerësimin e saj, si dhe krijimin e një përmbledhjeje të dobishme të literaturës.

14

#### Edukimi për kohë të lirë

Kursi *Edukimi për kohë të lirë* ofrohet për të promovuar procesin e njohjes së fenomenit të kohës së lirë, si dhe aktualizimin e nevojës për edukim për kohë të lirë. Në kurs trajtohen aspektet më të përgjithshme të dukurisë së kohës së lirë, në kontekst të arsimimit të qytetarëve për shfrytëzimin kreativ të saj. Në kurs trajtohet dimensionin i nevojës së aftësimin të rinjve për qasjen poliedrike e ndërfaqshme të kohës së lirë. Veçmas, trajtohet aspekti i konstituimit të disiplinës së pedagogjisë së kohës së lirë në kuadër të pedagogjisë, si dhe aktualizimi i saj në dekadat e fundit të shekullit XX. Në kurs do të trajtohen gjithanshëm edhe aktivitetet me të cilat përmbushet koha e lirë dhe veçmas trajtohet vështirësia në klasifikimin e tyre, sepse tani zhvillimi teknik, teknologjik e shkencor ofron përmbajtje të llojllojshme, me porosi shpesh të dyshimta, me të cilat të rinjtë mund ta përmbushin kohën e

	<p>lirë në dispozicion. Në kurs do të përpunohen e diskutohen bashkërisht me studentë përmbajtje, që udhëzojnë në edukimin e drejtë të studentëve për shfrytëzimin kreativ dhe përmbajtësor të kohës së lirë</p>
15	<p><b>Braktisja e shkollës</b></p> <p>Qëllimi i këtij kursi është, që studentët të marrin informacione më të mëdha, lidhur me braktisjen e shkollës nga nxënësit dhe për pasojat që i sjell ky fenomen shqetësues shoqërisë sonë. Të përvetësojnë njohuri për faktorët kryesorë, që e shkaktojnë braktisjen e shkollës nga nxënësit, sidomos pas viteve të 90-ta, ndërmarrjen e masave parandaluese, si dhe për rekomandimet që duhen ndërmarrë nga shoqëria, familja dhe komuniteti, për ta zbutur këtë fenomen, i cili si pasojë e kushteve të vështira ekonomike dhe të tjera, ka zënë të rritet nga dita në ditë.</p>
16	<p><b>Arsimimi gjatë gjithë jetës</b></p> <p>Kursi ofron përmbajtje bazike për lëndën, të arriturat dhe perspektivat e arsimit gjatë gjithë jetës në vend dhe më gjerë, duke vijëzuar periudhat e ndryshme në aspektin kronologjik-shkencor. Në kurs përpunohen përmbajtje aktuale të arsimit gjatë gjithë jetës, duke u përqendruar në ecuritë, modalitetet, mjetet si dhe rrethanat favorizuese të kësaj veprimtarie. Po ashtu, kursi është strukturuar në mënyrë që të zbardhë bazën e motivacioneve, interesave dhe qëndrimeve, për krijimin e klimës favorizuese për arsimim gjatë gjithë jetës. Kursi do të ofrojë përmbajtje teorike dhe aktivitete praktike, për t'u ndihmuar vijuesve të identifikojnë resurset e shumta, që ofron periudha e modernizimit industrial për arsimim gjatë gjithë jetës. Ata do të aftësohen sistematikisht në kërkimin e informacioneve në resurset aktuale për të nxënë gjatë gjithë jetës. Kursi do t'u mundësojë vijuesve të zhvillojnë dhe përsosin kulturën për arsimim gjatë gjithë jetës, e cila do të jetë në funksion të përcjelljes së risive në fushën e arsimit gjatë gjithë jetës edhe pas kryerjes së këtij niveli të arsimit.</p>
17	<p><b>Psikologji e zhvillimit</b></p> <p>Ky kurs do të paraqesë për studentët informatat bazike, të cilat shpjegojnë psikologjinë zhvillimore. Lënda do të shtjellojë në mënyrë të hollësishme zhvillimin njerëzor, duke filluar nga paralindja dhe vazhduar në fazat e më tutjeshme të zhvillimit. Diskutimet do të kenë për bazë perspektivat teorike, studimet shkencore dhe rastet studimore, që shpjegojnë të gjitha ndryshimet, të cilat njeriu kalon. Studentët do të mësojnë aftësi të nevojshme për të kuptuar dhe shkruar në mënyrë kritike dhe shkencore.</p>
18	<p><b>Pedagogji sistematike-II (edukimi socio-moral, estetik dhe punues)</b></p>

	<p>Kursi i ofron studentit njohuri bazike për komponentin teorik të edukimit moral, të edukimit socio – emocional, atij estetik e punues; njohuri për metodologjinë në këto fusha dhe shkathtësi të aplikimit të instrumentarit pedagogjik në procesin e edukimit moral, socio-emocional, estetik dhe punues.</p>
19	<p><b>Teoria pedagogjike e kurrikulës</b></p> <p>Kursi ofron njohuri bazike rreth koncepteve të kurrikulës, bazës filozofike, historike, sociologjike të kurrikulës, metodave për hartimin e kurrikulës dhe veçorive të saj. Studentët do të kenë mundësinë të analizojnë qasjet e hartimit të kurrikulës, mënyrat e zbatimit dhe të vlerësimit të kurrikulës. Në veçanti, temat pasqyrojnë metodat e ndryshme të hartimit të kurrikulës si: metoda bihavioriste, metoda akademike, metoda e sistemeve, rikonceptualiste etj. Mbi bazën e një analize të metodave e fushave të kurrikulës, reflektohet edhe për Kornizën e Kurrikulit të Kosovës, parimet, fushat, nivelet dhe aspektet tjera të saj, si dhe kurrikulën bërthamë dhe kurrikulën zgjedhore.</p>
20	<p><b>Statistikë pedagogjike</b></p> <p>Ky kurs është i dizajnuar që të njohë studentët me konceptet themelore dhe metodat e ndryshme statistikore, të cilat aplikohen për hulumtime shkencore pedagogjike. Studentët do të njihen fillimisht me frekuencat e formimin e klasave dhe paraqitjen grafike të gjetjeve, e cila është e pashmangshme për studim të dukurive masive pedagogjike. Pas fazës së parë njohëse me lëndën, studentët do mësojnë dhe aftësohen të gjejnë vlerat e ndryshme mesatare, duke u aftësuar të bëjnë ndarjen e një serie ose shpërndarjen e ranguar në dy pjesë të njëjta, duke vijuar me masat e shpërndarjes, të cilat mundësojnë studim të mirëfilltë të dukurive pedagogjike. Kursi u mundëson studentëve të mësojnë dhe aftësohen të gjejnë pozitën e rasteve individuale të studimit në grupe. Në hulumtimet pedagogjike përdorim metoda të ndryshme jo parametrike, të cilat janë të përfshira në përmbajtjen e lëndës në fjalë, ku studentët do të kenë mundësinë fillimisht t’i mësojnë dhe aftësohen t’i gjejnë ato. Gjithashtu, ata do aftësohen të zbulojnë edhe marrëdhëniet mes dukurive pedagogjike përmes korrelacionit, duke bërë përmbylljen e lëndës me aftësim të studentëve për përcaktimin e madhësisë së grupeve reprezentative.</p>
21	<p><b>Informimi dhe orientimi profesional</b></p> <p>Përmes këtij kursi do t’u ofrohen studentëve përmbajtje, që kanë të bëjnë me rëndësinë që ka informimi dhe orientimi profesional për të rinjtë sot, duke i nënkuptuar edhe të rinjtë, që janë me nevoja të veçanta, për të cilët është i nevojshëm rehabilitimi profesional dhe karriera e ardhshme. Të përvetësojnë,</p>

	<p>gjithashtu, të dhëna për përfitimet që u sjell të rinjve informimi dhe orientimi i drejtë profesional. Nga ky kurs ata do të njihen gjithashtu për mangësitë, që mund t'i sjellë, jo vetëm shoqërisë, po edhe individit, dështimi i të rinjve në profesion e punë dhe sa mund të ndikojë shkolla, po edhe faktorët tjerë që ky problem të ngrihet në shkallë profesionale dhe institucionale.</p>
22	<p><b>Menaxhimi i projekteve</b></p> <p>Kursi ofron njohuri bazike në fushën e menaxhimit të projekteve zhvillimore në institucione. Trajtohen tema që kanë të bëjnë me mënyrën e hartimit të projekteve, menaxhimin dhe vlerësimin e projekteve në institucione të ndryshme arsimore, kulturore e shoqërore në përgjithësi.</p>
23	<p><b>Zhvillimi profesional i mësimdhënësve</b></p> <p>Kursi paraqet një lëmi të veçantë në kuadër të pedagogjisë, që trajton qasje bashkëkohore të përgatitjes dhe aftësimin teorik e praktik të punonjësve të arsimit në shoqërinë bashkëkohore. Kursi udhëzon në njohjen dhe krahasimin e modeleve të ndryshme të zhvillimit profesional në kontekstin historik dhe bashkëkohor, si dhe tendencat, të cilat janë përvijuar në të kaluarën. Po ashtu, trajtohen edhe qasjet bashkëkohore për arritjen një koherence, që do të preferohej dhe pranohej gjerësisht, si nga shtetet e zhvilluara, po ashtu edhe nga shtetet në zhvillim. Në kurs trajtohen edhe përpjekjet e asociacioneve dhe të studiuesve për projektimin e politikave të përbashkëta në nivel ndërkombëtar. Analizohen përpjekjet për përpilimin e kriterëve, harmonizimin e qasjeve dhe standardizimin e politikave për zhvillimin dhe aftësimin profesional të punonjësve të arsimit/projekti Tuning/. Në kurs trajtohen dhe analizohen profesionalisht politikat arsimore për zhvillimin dhe përkryerjen profesionale të punonjësve të arsimit në nivel kombëtar, të hartuara nga autoritetet vendore në nivel të vendit, por të kundruara në raport me zhvillimet aktuale në vendet tjera.</p>
24	<p><b>Pedagogji e masmediave</b></p> <p>Kursi ofron njohuri nga fusha e masmediave dhe roli i tyre në formimin e personalitetit dhe zhvillimit të shoqërisë. Në kuadër të këtij kursi, trajtohen tema që kanë të bëjnë me rolin, ndikimin e fuqinë e medieve në formimin e personalitetit, për mënyrën e trajtimit të temave pedagogjike në media, përgatitja e emisioneve në media dhe roli i tyre, kriteret dhe kushtet për prezantimin e fëmijëve në media etj. Përmes këtij kursi ofrohen mundësi të debatimit të problemeve, kohës e vëllimit të temave pedagogjike të prezantuara në masmedia e veçmas në TV. Zhvillohen shkathtësi të analizës e prezantimit adekuat të temave edukative në masmedia.</p>

25	<p><b>Pedagogji speciale</b></p> <p>Kursi ofron njohuri bazike në fushën e pedagogjisë speciale, personat me nevoja të veçanta, dëmtimet e natyrave të ndryshme dhe mundësinë e integritit të personave në procesin e edukimit. Gjithashtu, trajtohen tema që promovojnë filozofinë e arsimit inkluziv. Përmes këtij kursi, studentët do të kenë mundësi të njihen me dëmtimet e llojeve të ndryshme: dëmtimet në të parë, në të dëgjuar, vështirësitë në komunikim, prapambetjen mendore etj. Kursi ofron edhe analizë të hollësishme të strategjive të mësimdhënies për punë me nxënës me nevoja të veçanta, forma e aktivitete të ndryshme, të cilat promovojnë vlerat e arsimit gjithëpërfshirës.</p>
26	<p><b>Andragogji</b></p> <p>Kursi i <i>Andragogjisë</i> përmban përmbajtje aktuale nga sfera bio-sociale e njeriut të rritur si qenie gjenerike (mbi moshën 18 vjeçare), si shkencë relativisht e mëvetësuar dhe me perspektivë. Në kurs do të trajtohen përmbajtje teorike, që ndërlidhen me historinë dhe veprimtarinë e mendimit andragogjik, të para nga një këndvështrim kronologjik. Kursi ofron përmbajtje për sistemet arsimore për të rriturit, si dhe trajton determinantët që e kushtëzojnë nevojën e ndryshimit të të rriturve. Do të përpunohen me studentë përmbajtje, që trajtojnë kuptimin e nocionit “njeri i rritur”, dimensionin psiko-fiziologjik të arsimimit të të rriturve, duke u përqendruar në gjendjen fizike e sensitive, aftësitë intelektuale, motivacionet, interesat e qëndrimet në funksion të arsimimit të tyre, grupin arsimor dhe dinamikën e tij, duke u përqendruar në kuptimin, strukturën, udhëheqjen dhe dinamikën e tij dhe në veçanti, do të debatohet për mekanizmat nga të cilët varet dinamika e grupit arsimor. Kursi do të trajtojë edhe dimensionin e nevojave arsimore në organizatë dhe elementet përmbajtjesore të të ashtuquajturit “cikli andragogjik”, duke e ndërlidhur atë edhe me aspektin praktik për strukturimin dhe përpilimin e një planifikimi hipotetik të nevojave arsimore të një organizate.</p>
27	<p><b>Bazat teknologjike të punës mësimore</b></p> <p>Kursi <i>Bazat e teknologjisë në arsim</i> ofron informacionet bazike për teknologjinë arsimore dhe zbatimin e saj në praktikën mësimore. Në kurs trajtohen aspektet më elementare, prej mjeteve natyrore, artificiale në veprimtarinë arsimore dhe pastaj përpunohen edhe mjetet e sofistikuara të mësimin në distancë. Do të trajtohet, po ashtu edhe zbatimi i teknologjisë arsimore në punën e përditshme arsimore, por edhe hulumtuese e shkencore. Në kurs do të përpunohen shumë përmbajtje aktuale që sjell zhvillimi teknik, teknologjik e shkencor në sferën e teknologjisë arsimore në kushtet e</p>

	<p>zhvillimit të vazhdueshëm në shoqërinë bashkëkohore. Do të ketë udhëzime praktike, për ta promovuar punën praktike në zbatimin e teknologjisë ekzistuese në mësimdhënie. Do të debatohet edhe për dimensionet e shumta, që ofron teknologjia bashkëkohore aktuale, kundruar nga këndi perspektiv, po ashtu.</p>
28	<p><b>Shkathtësitë e studimit akademik</b></p> <p>Kursi i ofron studentit njohuri për shkathtësitë e studimit akademik si: shkrimi, leximi, dëgjimi, komunikimin e prezantimi akademik, gjithnjë të gërshetuara me të menduarin kritik dhe e aftëson të aplikojë gjatë studimeve; shkathtësi të shkrimit dhe të vlerësimit kritik të esesë, shkrimit të raportit kërkimor, komunikimit e prezantimit dhe vlerësimit kritik të tij; të leximit akademik, të llojeve dhe teknikave të leximit si dhe aftësi të reflektimit kritik; të dëgjimit akademik, si dhe aplikim e vlerësim të tij; njohuri dhe shkathtësi për komunikim e prezantim akademik dhe vlerësim kritik të performancës.</p>
29	<p><b>Puna instruktive pedagogjike</b></p> <p>Ekziston një mungesë e dukshme e profesionistëve shkollorë të përgatitur për të lëvizur dhe për t'u bërë aktorë kompetentë në përmirësimin e shkollës. Sfida e reformimit arsimor, numri i madh i të regjistruarve në shkolla dhe akcelerimi i të pensionuarve, krijon nevojën për profesionistë të dijshtëm dhe të shkathtë, të gatshëm për të hyrë në veprim. Presioni shkollor dhe ai shoqëror, fëmijëria dhe periudha e adoleshencës i shtojnë nxënësit të kërkojnë një udhërrëfyes të kujdesshëm profesional, që është në shërbim të sigurisë së mjedisit të tyre shkollor. Lënda ju ofron studentëve aspektet teorike dhe praktike të këtyre çështjeve, me qëllim të përballjes me nevojat në rritje të parashkollorëve, të nxënësve të shkollave fillore dhe të mesme, duke u dhënë udhëzime për intervenim efektiv dhe për përparim shkollor e menaxhim të sjelljes. Si i tillë, ky kurs ju jep studentëve mjetet e nevojshme për adresimin e shqetësimeve të mësimdhënësve, prindërve, profesionistëve të tjerë në shkollë dhe komunitetit dhe për ballafaqimin më efektiv me sfidat dhe çështjet komplekse të fëmijëve dhe adoleshentëve të sotëm. Këto përpjekje mund të kontribuojnë në përmirësimin e klimës në shkollë, shkathtësive mësimore të nxënësve, arritshmërisë në të nxënë, vetëdijesimit për zgjedhjen e profesionit dhe zhvillimin e karrierës, si dhe në përmirësimin e sjelljes së nxënësve.</p>
30	<p><b>Metodat e punës social-pedagogjike</b></p> <p>Ky kurs i'u mundëson studentit të përvetësojë njohuri mbi: zhvillimin e</p>



	<p>metodave të punës sociale, veçoritë e metodave vepruese të punës sociale, metodat e punës sociale në rast, metoda e punës sociale në grup, thellimi i një shkolle të caktuar mbi metodat e punës sociale, teknikat e intervenimit, format e intervenimit, kompetenca e reflektimit etj.</p>
31	<p><b>Psikologji e edukimit</b></p> <p>Psikologjia e edukimit tenton të shpjegojë të mësuarit/të nxënit. Si një degë interdisiplinare e psikologjisë dhe edukimit, trajton një seri çështjesh praktike dhe teorike. Si degë e psikologjisë, studion sjelljen njerëzore me përqendrim në zhvillimin e saj dhe të mësuarit. Si edukim, ka të bëjë me aplikimin e njohurive në proceset, ku të mësuarit ndodh (shkolla dhe mjedise të tjera). Psikologjia e edukimit sqaron zhvillimet kognitive, gjuhësore, personale, sociale dhe morale, të cilat janë relevante për të kuptuar sjelljen e individëve, dallimet në mes të individëve.</p>
32	<p><b>Metodikë me punë praktike</b></p> <p>Ky kurs do t'ju japë mundësi studentëve për zbatimin e ideve didaktiko-metodike dhe njohurive të tyre teorike për nxënien dhe mësimdhënien në mjediset reale shkollore. Ajo ofron qasje fundamentale metodike për asistimin e mësimdhënësve në procesin e dizajnit, strukturimit, planifikimit dhe organizimit të aktiviteteve mësimore për të gjithë nxënësit. Shumë mësimdhënës të shkollave në Kosovë punojnë me klasa të mbingarkuara dhe në mjedise pa përkrahje. Ata kanë nevojë për ndihmë praktike në dizajnimin e aktiviteteve për nxënësit e tyre, duke marrë për bazë (1) rezultatet e synuara, të përkufizuara në kuptim të njohurive, shkathtësive, kompetencave kurrikulare dhe përparimit të pritur; (2) grupin e nxënësve, të përkufizuar në kuptim të nevojave, përvojave të mëparshme, pritjeve, shkathtësive dhe kompetencave të nxënësve; dhe (3) mjedisin mësimor, të përkufizuar në kuptim të burimeve njerëzore dhe mjeteve fizike e digjitale. Prandaj, hapi më i rëndësishëm në procesin e mësimdhënies është planifikimi paraprak i tij, i menduar mirë dhe me kujdes. Ai ju siguron profesionistëve arsimorë, jo vetëm që t'i arrijnë rezultatet e të nxënit të parapara në kurrikulën shkollore, por që të realizojnë potencialin e plotë dhe të vërtetë të secilit nxënës. Kjo është vlera madhore e përmbajtjes së paraparë për këtë kurs.</p>
33	<p><b>Pedagogji parashkollore me punë praktike</b></p> <p>Kursi ndërton konstituimin dhe zhvillimin e pedagogjisë parashkollore si shkencë; analizën e nocionet bazike, karakteristikat e moshës; teoritë psikologjike dhe pedagogjike të avancuara për edukimin parashkollor në</p>

	<p>krahasueshmëri me ato të vjetruara; ligjësitë, parimet, qëllimet dhe faktorët primarë të edukimit parashkollor; strategjitë e edukimit parashkollor dhe reflektimi kritik për to; praktikat e edukimit parashkollor.</p>
34	<p><b>Pedagogji komparative</b></p> <p>Ky kurs ka të bëjë me aftësimin e studentëve për zanafillën, nevojën dhe aktualitetin e pedagogjisë komparative, që ka për bazë njohjen e disa prej sistemeve arsimore të shteteve ballkanike, evropiane dhe botërore. Kjo njohje, do t'u mundësojë, që të bëjnë krahasime, duke i parë specifikat, dallimet dhe ngjashmëritë në mes vete. Të përvetësojnë njohuri, gjithashtu, për tendencat e përgjithshme në fushën e arsimit të të gjitha niveleve të shkollimit, të reformës arsimore, duke nënkuptuar këtu: politikën arsimore, autonominë e shkollës, demokratizimin e shkollës, decentralizimin-centralizimin, standardizimin e arsimit, kurrikulën, teknologjinë e arsimit, financimin e arsimit, organizmat dhe institucionet ndërkombëtare të arsimit, globalizmin dhe arsimin kombëtar, strategjitë dhe perspektivat e tyre.</p>
35	<p><b>Standardet në arsim</b></p> <p>Nga kursi do t'u ofrohen studentëve përmbajtje thelbësore për çështjet e përgjithshme, që kanë të bëjnë me standardet në arsim dhe rëndësinë e tyre, për efikasitetin e sistemit të arsimit dhe edukimit në Kosovë. Ata do të zotërojnë dituri për nevojën e monitorimit dhe të vlerësimit të standardeve dhe për të bërë përpjekje për t'i arritur ato në armim. Do të mësojnë, gjithashtu, për rëndësinë që ka vlerësimi i standardeve lëndore dhe të përmbajtjes.</p>
36	<p><b>Pedagogji e përkujdesjes dhe strehimit</b></p> <p>Në kuadër të këtij kursi studentët fitojnë njohuri teorike dhe praktike: në fushën e këshillimit pedagogjik sistematik në kontekstin shkollor, në fushën e proceseve edukative dhe të mësimnxënies, në fushën e qasjes dhe zgjidhjeve të konflikteve, situatave stresuese, situatave emergjente, në fushën e moderimit, prezantimit dhe këshillimit mbi zhvillimin e ekipeve, në fushën e sjelljeve të nxënësve në mësim, në fushën e strategjive në lidhje me parandalimin e varësive, në fushën e njohurive teorike mbi arsyet dhe format dhe ndikimin e dhunës, në fushën e këshillimeve dhe të përdorimit të teknikave, në fushën e analizës së arsyeve të konflikteve.</p>
37	<p><b>Vështirësitë në të nxënë</b></p> <p>Ky kurs trajton gjendjen e vështirësive në të nxënë, çështje kjo e njohur dhe e pranuar tashmë në përmasa të gjera, e cila çon drejt vështirësive serioze në</p>

të nxënit shkollor dhe shpesh edhe në jetën e mëvonshme të të rriturit. Për më tepër, gjendja e vështirësive në të nxënë përfaqëson një çështje universale, që paraqitet në të gjitha kulturat, kombet dhe gjuhët e botës. Përkundër posedimit të inteligjencës mesatare, madje edhe mbimesatare, individët me vështirësi në të nxënë përjetojnë vështirësi të theksuara dhe të qëndrueshme në përvetësimin dhe përdorimin efikas të shkathtësive për lexim, për shkrim ose për matematikë. Ideja, që një fëmijë mund të jetë edhe i zgjuar edhe me vështirësi në të nxënë, tingëllon si një paradoks. Shpesh ndodh që këta fëmijë të duken si nxënës mesatarë, e jo rrallë edhe si të dobët, pasi zgjuarsia e tyre dhe aftësia e kufizuar në të nxënë e maskojnë njëra-tjetrën. Shqetësimi për këta fëmijë sa vjen e rritet, për shkak se ata nuk shërbehen nga sistemi arsimor. Prandaj, kursi ofron njohuri teorike dhe shkathtësi praktike, për të kuptuarit e drejtë se kush janë këta fëmijë/nxënës, përpjekjet dhe sfidat me të cilat ata përballen, mënyrën e adresimit në të mirë të nevojave të tyre, si dhe rolin që mësimit dhe prindërit luajnë në jetën e tyre.

38

Punim i diplomës

Punohet në bashkëpunim me profesorin mentor sipas rregullores së Fakultetit të Edukimit për studime Bachelor.